



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401616/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për kryerjen e menjëhershme të veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e vendimit Nr. 2027, datë 02.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.*

Drejtuar: Kryetarit të Zyrës së Përmbarimit
Z. Arjan ÇEPELE

Fier

Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit
Z. Albert PILO

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja Xh.K. me banim në fshatin Shënpjetër, Komuna Topojë, rrethi Fier. Ankuesja shkruan se, ka qënë e martuar me shtetasin K. P. me të cilin ka dy fëmijë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin Nr. 2027, datë 02.12.2010 ka vendosur: Zgjidhjen e martesës së lidhur ndërmjet tyre. Lënien e fëmijëve S. e B. P. për rritje dhe edukim paditëses Xh. K. Detyrimin e të paditurit K.P. të paguaj detyrim ushqimor për fëmijën S. P., i dtl. 05.09.2002, në masën 8000 lekë në muaj dhe për fëmijën B. P., i dtl. 23.05.2005, në masën 7000 lekë në muaj.

Ky vendim ka marë formë të prerë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin Nr. 62-2011-630-(112) datë 09.03.2011 ka lëshimin e urdhit për ekzekutimin e vendimit Nr. 2027, datë 02.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Meqënëse i padituri K. P. nuk e ka bërë ekzekutimin e vendimit gjyqësor në mënyrë vullnetare, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Fier për ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Megjithëse kanë kaluar rreth 4 vjet, nga zyra e Përmbarimit Fier nuk është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit gjyqësor të cituar më sipër me justifikimin se, nga kërkimet që ka bërë kjo zyrë nuk ka gjetur pasuri në emër të debitorit.

Ndërmjet institucioneve të tjera, Zyra e Përmbarimit Fier i është drejtuar edhe ZVRPP Fier, e cila me shkresën Nr. 1098/1 Prot., datë 12.05.2011 i ka

kthyer pergjigje se në emër të debitorit K. P. nuk rezulton të ketë regjistruar pasuri të paluajtshme.

Ankuesja pretendon se, në fakt shtetasi K. P. ka pasuri të paluajtshme, tokë bujqësore, të cilën e ka përfituar nga Ligji nr. 7501 "Për tokën". Kjo pasuri i është dhënë familjes bujqësore dhe është në emër të babait të tij, shtetasit N. Th. P. Toka bujqësore është në bashkëpronësi, është në 5 ngastra me sipërfaqe totale 28 931 m², ndodhet në fshatin Seman, Komuna Topojë, rrethi Fier. Këtë fakt ajo e provon me dokumentat që ka lëshuar Komuna Topojë, si shkresa (Kthim përgjigje) nr. 472/1 prot., datë 24.09.2014, fotokopjen e formularit nr. 6, dhe çertifikatën familjare (përbërja familjare e shtetasit Kleanthi Prifti në datën 01.08.1991). Sipas saj, toka bujqësore që ka përfituar familja e debitorit Kleanthi Prifti është e regjistruar në ZVRPP Fier në emër të shtetasit Naun Th. P. Gjithashtu ajo pretendon se, Zyra e Përmbarrimit Fier qëllimisht nuk i ka kërkuar ZVRPP Fier verifikimin e pronësisë të shtetasit N. P., bashkëpronarë i të cilës është edhe shtetasi K. P., si pjestarë i familjes bujqësore anëtare e Kooperativës Bujqësore të Tipit të Lartë Seman Fier.

Për të shqyrtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese, ne iu drejtuam me kërkesë për shpjegime Zyrës së Përmbarrimit Fier dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Fier. Në kërkesat tona i parashtruam edhe pretendimet e ankueses të përshkruara më sipër, duke i theksuar pretendimin e saj se, **debitori disponon, posedon dhe gëzon pasuri të paluajtshme, tokë bujqësore, në bashkëpronësi me familjarët e tij.**

Zyra e Përmbarrimit Fier me shkresën Nr. 87 Prot., datë 02.10.2014 na ka informuar se, citojmë: "Nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Fier janë kryer veprimet procedurale përmbarrimore bazuar në nenin 527 të K.P.C. të venie sekuestro mbi sendet e paluajtshme.

Në shkresën me Nr. 193 Prot., drejtuar Z.V.R.P.P. Fier nga ana jonë për venie sekuestro në pasuri të debitorit theksoj se:

Bazuar në shkresën me Nr. 1098/1 Prot., kthim përgjigje nga Z.V.R.P.P. Fier ku rezulton se në emër të debitorit **K. N. P. nuk figuron pasuri e regjistruar**".

Sikurse rezulton nga kjo përgjigje, të cilën e cituam më sipër, për të dyja shkresat, si ajo e vetë Zyrës së Përmbarrimit Fier ashtu edhe ajo e Z.V.R.P.P. Fier nuk është pasqyruar data.

Por ajo që është më e rëndësishme qëndron në faktin se, megjithëse nga ana jonë i është theksuar Zyrës së Përmbarrimit se pasuria e paluajtshme, tokë bujqësore, e debitorit është në bashkëpronësi me familjarët e tij dhe e regjistruar në emër të të atit të tij, shtetasit Naun Thoma Prifti, kjo zyrë kthen një përgjigje formale dhe jo korrekte duke deklaruar se, **në emër të debitorit Kleanth Naun Prifti nuk figuron pasuri e regjistruar.**

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Fier me shkresën Nr. 6375/1 Prot., datë 15.10.2014 na informoi se, nga verifikimet e bëra rezultoi se, citojmë:

"Z. K. P. ka qënë anëtar i familjes bujqësore të Z. N. P. të trajtuar me tokë nga ligji Nr. 7501 "Për tokën" në fshatin Seman, Komuna Topojë dhe konkretisht në pasuritë me të dhënat si më poshtë:

- Pas. 16/14 ZK. 3300 vol. 2, fq.214, Arë me sip. 10 090 m².

- Pas. 50/9 ZK. 3300 vol. 2, fq. 215, Arë me sip. 1 908 m2.
- Pas. 51/9 ZK. 3300 vol. 2, fq. 216, Arë me sip. 2 620 m2.
- Pas. 75/6 ZK. 3300 vol. 2, fq. 217 Arë + truall me sip. Totale prej 400, nga e cila 250 m2 truall dhe 80 m2 ndërtesë.
Sqarojmë se këto pasuri janë regjistruar gjatë procesit të regjistrimit fillestar në emër të kryefamiljarit N. Th. P., por për këto pasuri nuk janë paraqitur dokumentacion tekniko-ligjor për pajisjen me Çertifikatë Pronësie.
- Pas. 9/33 ZK. 3300 vol. 8, fq. 9, Arë me sip. 16 100 m2 në emër të N. Th. P. kryefamiljar me 6/7 F + 1/28 B dhe Ll. Th P., L.Th. P., D. Th. P. me nga 1/28 B, (të pajisur me Çertifikatë Pronësie dt. 08.11.2013”.
Gjithashtu kjo zyrë na ka dërguar edhe kopje të dokumentacionit të regjistrimit të pasurisë 9/33.

Nga përgjigjia e ZVRPP Fier rezulton se, debitori K. P. ka pasuri të paluajtshme në bashkëpronësi të familjes bujqësore. Disa prej tyre janë në fazën e regjistrimit fillestar, ndërsa për një të tjetër prej tyre është bërë regjistrimi përfundimtar dhe është lëshuar edhe Çertifikata e Pronësisë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese arrijmë në konkluzionin se, nga Zyra e Përmbartimit Fier nuk janë kryer të gjitha veprimet procedurale konform ligjit për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Kjo zyrë, megjithëse i është bërë e ditur si nga pala kreditore ashtu edhe nga institucioni ynë, nuk ka kryer asnjë veprim për verifikimin, gjetjen dhe vënien e sekuestros ndaj pasurisë së paluajtshme të debitorit të cilën e ka në bashkëpronësi si familje bujqësore dhe të regjistruar në emër të të atit të tij, shtetasit N. Th. P.. Për rrjedhojë ajo nuk ka zbatuar edhe detyrimin e parashikuar në nenin 578 të KPC për t’ju drejtuar gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar dhe të bëjë ekzekutimin e detyrimit nga kjo pjesë.

Theksojmë se, neglizhenca dhe qëndrimi mosveprues i Zyrës së Përmbartimit Fier për të kryer detyrën ligjore për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv të cituar më sipër, ka sjellë si pasojë rëndimin e situatës ekonomike të ankueses dhe fëmijëve të saj dhe vështirësi për rritjen dhe edukimin e tyre.

Për të bërë të mundur realizimin e të drejtës ligjore të ankueses, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike“ dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË:

1. Marjen e menjëhershme të masave të nevojshme për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendimit Nr. 2027, datë 02.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në favor të ankueses Xh. K..

2. Vënien e sekuestros ndaj pasurisë së paluajtshme të debitorit të cilën e ka në bashkëpronësi si familje bujqësore dhe të regjistruar në emër të shtetasit N. Th. P., me të dhënat e përshkruara më sipër.
3. Zbatimin e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 578 të KPC për t'ju drejtuar gjykatës për veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar K. P. dhe ekzekutimin e detyrimit të tij nga kjo pjesë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe fotokopje të përgjigjes së Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Fier dërguar institucionit tonë me shkresën Nr. 6375/1 Prot., datë 15.10.2014.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI